
	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b>  <b>Republika Kosova –</b>  <b>Republic of Kosovo</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b>  Opština Priština –Municipality  of Prishtina</p>	
---	---	---

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 25.02.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: Pro Tech Clean SH.P.K, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”**, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, Autoriteti Publik – Komuna e Prishtinës me datë: 01.03.2023 nxjerr:

## V E N D I M

1. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: Pro Tech Clean SH.P.K e parashtruar me datë: 25.02.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të AK -së, të datës 10.02.2022 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
2. **Autoriteti Publik vendos të bëjë ndryshimet në pikën 2 të dispozitës 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit.**
3. **Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1.**
4. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>**

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues me datë: 10.02.2023 ka bërë publik Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetit të prokurimit me titull:

**“Pastrimi i objekteve shkollore - Shkollat e mesme dhe institucionet parashkollore në Komunën e Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-781-2-1-1**

Ju si Operator Ekonomik keni ushtruar të drejtën e juaj për Kërkesë për Rishqyrtim, pra me datë: 25.02.2023, ku keni paraqitur pretendimet ankimore si në vijim:

*Bazuar në pyetjet për sqarime shitesë të dosjes së tenderit të cilat i kanë bërë Operatoret Ekonomik, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë përgjigje në disa pyetje konform pyetjeve të Operatoreve Ekonomik.*

*1. Kërkesë e AK-së ka qenë që punëtorëve duhet t’iu paguhet përvoja e punës sipas ligjit të punës 03/L-212. AK është i obliguar që të llogaris saktë vlerën e stazhit të punëtorëve për 1 muaj ashtu siq është bërë në aktivitetet e prokurimit të mëparshëm.*

*2. Keni Kërkuar në Kërkesën NR 5. Se Operatoret Ekonomik duhet të të deklarohen se materialet e përdorura janë ekologjike dhe të atestuara, duke pas parasysh se ligji i prokurimit neni 61 bëhet fjalë për qmime jo normalisht të ulta të materialit higjienik dhe shumë OE ofertojnë me qmime jo normalisht të ulëta, atëher pyetja jonë është se si të orientohemi për qmime të materilait.*

*Përgjigja nga AK ka qenë se duhet të orientohemi në cmimet e tregut, mirepo AK nuk është përgjigjur konform pyetjes së OE në lidhje me cmimet jo normalisht të ulëta duke e pasur parasysh se Ligji i Prokurimit Publik neni 61 sqaron mirë për ofertat me cmime jo normalisht të ulëta që e bëjnë ofertën e pa përgjegjshme.*

*3. Tek pyetja e oe: Në Aneksin 8 , në tabelë , nr 3: Makinë me motor për pastrimin e hapësirës së jashtme (makina duhet të jetë me fshesë) sasia 3 copa, keni dhene përgjigje: “ se OE duhet ti kete 3 makna per pastrimin e hapsirave te jashtme. Ky kriter eshte kriter i larte per arsye se siperfaqet te cilat jane te asfaltuara, jane shume te paketa ne krahasim me hapsirat e gjelbruara dhe ne asnje aktivitet te meparshem per keto shkolla nuk jane kerkuar keto makina andaj mendojme se ka favorizime dhe shkelet neni 7 ( Barazia ne trajtim / jo- diskriminimi).*

*4. Tek vlere e parashikuar ju keni dhene nje përgjigje se kete vlere e parashikon njesia kerkuese dhe se kjo vlere eshte konform kerkesave dhe zgjatjes se kryerjes se sherbimeve per pastrim.*

*Pasi qe ju si AK keni kerkuar nje analize financiare e cila analize perfshine: pervojen e punes, pushimet vjetore sipas ligjit, materilain shpenzues etj, ne do te elaborojme kete*

*analize si ne vijim.*

*Keni kerkuar 45 puntore ku paga neto te jete 300 euro. Kur kjo paga te llogaritet me ta gjitha tatimet e aplikueshme sipas skemes se ATK-se del se paga per nje puntore me te gjitha kontributet del te jete 406.60 euro:*

*45 puntore x 406.60 euro = 18,297.00 euro x 15 muaj 274,455.00 euro vlera e pagave me te gjitha tatimet e aplikueshme, kur te llogaritet edhe materialit, pushimet vjetore dhe pervoja e punes atehere del se vlera e parashikuar eshte me e vogel se kerkesat te cilat jane ne dosjen e tenderit.*

### **Baza Ligjore për aprovim të pjesshëm të kërkesës**

Autoriteti Kontraktues në bazë të sqarimeve të dosjes së tenderit dhe korrigjimeve në njoftimin për kontratë ka përcaktuar qartë kriteret e dosjes së tenderit duke respektuar dispozitat e LPP-së në veçanti nenin 7 të LPP-së.

Pretendimet e OE ankimor si pretendimi 1, 2 dhe 3 janë dhënë me sqarim për tender dhe mbesin ashtu siç janë përcaktuar në kriteret në dosje të tenderit.

Ndërsa sa i përket pretendimit 4 lidhur me pagën neto 300 euro për 45 punëtor, Autoriteti Publik pas konsultimit me Njësinë Kërkuese lidhur me mundësinë e rritjes buxhetore në vlerën e parashikuar ka marrë përgjigje nga Njësia Kërkuese që nuk mund të rritet vlera e parashikuar andaj AK do të zvogëloj kërkesën për pagën neto nga **300 euro** në **250 euro neto** ndërsa vlera e parashikuar mbetet e njëjtë si në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë.

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Iu dorëzohet:

*Departamentit të Prokurimit  
Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi  
Arkivit*

Visar Shehu – U.D. – Departamenti i Prokurimit

